



Програма „Форуми
во заедницата“

Community
Forums Programme

Programi
“Forume në bashkësi”

PROGRAMI “FORUME NË BASHKËSI”

**INTERVISTË ME
KRYETARIN E KOMUNËS SË PEHÇEVËS
„PRES QË TË RRSIM
BESIMIN TE QYTETARËT“**



**PËRZGJEDHJE E
10 KOMUNAVE PËR ZBATIMIN E FORUMIT
BUXHETOR 2016/2017**

**TRAJNIM PËR PREZANTIM
EFEKTIV TË BUXHETEVE KOMUNALE**

FORUMI SIPAS SESIONEVE



Intervistë – Igor Popovski,
Kryetar i Komunës së
Pehçevës

PRES QË TË RRISIM BESIM TE QYTETARËT



Shpresojmë se do të arrijmë cilësi të re në komunikimin me qytetarët, gjegjësisht institucionet lokale, bashkësi afariste, sektorin civil dhe segmentet tjera nga bashkësia lokale në drejtim të programimit real të nevojave të qytetarëve, shprehet Kryetari i Komunës, Popovski

1. Komuna e Pehçevës e zbaton për herë të parë procesin e Forumit buxhetor. Cilat janë pritjet Tuaja nga mbajtja e forumit?

Komuna e Pehçevës për herë të parë do të zbatojë procesin e Forumit buxhetor sivjet, gjegjësisht bashkë me qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejt do të krijojë buxhetin komunal për vitin 2017. Planifikimi buxhetor dhe përgatitja e buxhetit është proces kompleks dhe sfidë për administratën komunale dhe për kryetarët e komunave, por

sivjet, duke iu falënderuar Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Njësisë për Koordinim të Forumeve (NJKF) përmes formës së forumit buxhetor do të zbatojmë një proces të edukimit dhe njoftimit të qytetarëve me atë se cilat janë të ardhurat dhe shpenzimet me të cilat financohen punët dhe kompetencat e komunës gjatë një viti fiskal dhe njëherësh në praktikë do ta zbatojmë përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Shpresojmë se do të arrijmë cilësi të re në komunikimin me qytetarët, gjegjësisht institucionet lokale, bashkësi

afariste, sektorin civil dhe segmentet tjera nga bashkësia lokale në drejtim të programimit real të nevojave të qytetarëve në korrelacion me kapacitetin, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e buxhetit, duke respektuar me këtë rast parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Si pjesëmarrës i drejtpërdrejt në dy ciklet paraprake të forumit, personalisht pres që sërish të dalloj entuziazmin dhe përkushtimin në fytyrat e bashkëqytetarëve të mi – pjesëmarrës në sesionet e forumit të cilët u angazhuan në faza të ndryshme të procesit të forumit dhe iu qasën me përgjegjësi përcaktimit të prioriteteve të nevojave të popullatës në drejtim të përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike të bashkësisë.

Gjithashtu, pres që ta rrisim besimin e qytetarëve drejt punës së vetëqeverisjes lokale duke e zbatuar forumin si praktikë e mirë dhe njëherësh të krijohet një energji e re pozitive që bashkë do të na shpie drejt zgjidhjes së suksesshme të problemeve në Komunën e Pehçevës.

2. A konsideroni se Forumi buxhetor mund t'ju ndihmojë në përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe zhvillimore të komunës?

Konsideroj se gjatë sesioneve të forumit do të marrim një perceptim të ri të realitetit në bashkësi dhe pres shumë propozime reale, sugjerime, ide dhe projekte kreative që do të përfshihen në prioritetet tashmë të dallueshme zhvillimore të komunës, por ndoshta gjatë procesit do të vijmë bashkërisht edhe deri te njohuritë/mundësitë e reja për avancimin e potencialeve të caktuara që mund të kenë rol vendimtar në zhvillimin e Komunës së Pehçevës. Jam i sigurt se informacioni i

fituar drejtpërdrejt nga qytetarët gjatë Forumit buxhetor do të gjejë vendin e tij në dokumentet strategjike dhe zhvillimore të komunës në kontekst të sendërtimit të tyre në nivel të qëllimeve, programeve, projekteve dhe aktiviteteve.

3. Nëse dhe sa është i përgatitur pushteti vendor për t'iu përgjigjur në mënyrë transparente dhe llogaridhënese kërkesave të qytetarëve gjatë përpilimit të buxhetit?

Komuna e Pehçevës i kushton vëmendje të madhe respektimit të parimeve të transparencës dhe llogaridhënies në punën ndaj qytetarëve dhe njëherësh punon vazhdimisht në sendërtimin e komunikimit të dyanshëm në relacionin qytetar-komunë. Praktikën që e filluam para katër viteve për publikimin e dokumenteve financiare të komunës dhe të ndërmarrjeve publike e respektojmë edhe sot e kësaj dite, njëherësh duke synuar për çdo ditë informimin me kohë dhe të saktë të

qytetarëve për të gjitha aktivitetet që i ndërmerr vetëqeverisja lokale. Gjithashtu, në faqen tonë të internetit dhe në tabelat e shpalljeve publikojmë rregullisht informacione për të gjitha projektet dhe aktivitetet rrjedhëse implementimi i të cilave ka implikime financiare ndaj buxhetit të komunës, e që në fakt mbështetet në propozimet e qytetarëve drejtuar kryetarit të komunës në procesin paraprak të forumit, gjegjësisht forumin e projektit të viteve 2012–2014 dhe Forumit për ujëra të viteve 2013–2015.

Komuna e Pehçevës ka kapacitete të kufizuara financiare, por jemi krenarë me faktin që pjesa më e madhe e propozimeve të deritanishme të qytetarëve nga procesi i forumit janë realizuar, ndërsa pjesa më e vogël janë në fazë të përgatitjes ose implementimit. Sa i përket përgatitjes së kërkesave të qytetarëve të përfshihen në buxhetin për vitin 2017, mund të them se imperativ në përgatitjen e buxhetit për vitin e ardhshëm do të jetë ai të jetë i mbështetur në propozimet e qytetarëve të Komunës së Pehçevës.

PËRZGJIDHEN 10 KOMUNA QË DO TË MBAJNË FORUME BUXHETORE MË 2016/2017

Edhe 10 komuna do të zbatojnë forum buxhetor gjatë periudhës së viteve 2016/2017 janë zgjedhur në kuadër të programit "Forume në bashkësi" në prill të këtij viti,

me ç'ka numri i proceseve të forumeve buxhetore të zbatuara në vitin 2014/2017 janë rritur në 30 procese.

Komunat Berovë, Pehçevë, Mogilë, Gradsko, Probishtip, Koçanë, Studeniçan, Zhelinë, Bërvenicë dhe Saraj janë komunat e reja që bashkë me qytetarët do të krijojnë buxhetin komunal për vitin e ardhshëm 2017. Implementimi i pesë sesioneve të forumit shtator/dhjetor të vitit 2016 tashmë filloi të realizohet, ndërsa pritet që sesionet vijuese të forumit të mbahen në shkurt, vitin e ardhshëm.

Forumet në komunat do t'i përfshijnë banorët, bashkë me administratat komunale, në krijimin e buxheteve për vitin e ardhshëm, do ta prezantojnë strukturën e buxhetit, të ardhurat (si mbushet buxheti), shpenzimet (si dhe ku të

shpenzohen mjetet buxhetore) dhe do t'i përcaktojnë si prioritet projektet më të rëndësishme në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në bashkësitë lokale.

Përzgjedhja e komunave është në kuadër të "Ciklit të tretë" nga "Faza dalëse" e programit, që zgjatë prej vitit 2014 deri në vitin 2017 dhe përfshinë aktivitete në përputhje me kalendarin buxhetor të vetëqeverisjeve lokale qëllimi i të cilave është përpunimi i buxheteve komunale.

Zbatimin e procesit të forumit buxhetor e financoi Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), me mjete të domosdoshme për mbështetjen e aktiviteteve për realizimin e procesit buxhetor.

FORUMI NË SESIONE

Gjatë periudhës mars-shtator të vitit 2016, u mbajtën disa sesione vijuese të forumit në komunat të cilat vjeshtën e kaluar i përgatitnin buxhetet komunale bashkë me qytetarët për këtë vit. Komunitet Konçë, Krivogashtan, Demir Kapi, Rosoman, Probishtip, Makedonski Brod dhe Dellçevë i prezantuan buxhetet e realizuara para banorëve dhe rrjedhën e realizimit të projekteve që ishin përcaktuar si prioritete nga qytetarët.

Në këtë periudhë, Komuna e Gradskos e mbajti sesionin e parë të forumit nga forumi buxhetor i cili për herë të parë zbatohet në këtë komunë. Edhe komunat tjera, ku banorët bashkë me administratat komunale do ta përgatisin buxhetin për vitin 2017, në tre muajt e ardhshëm do të mbajnë nga pesë sesione të forumit.

SESIONE TË FORUMIT PËR BUXHETIN NË VITIN 2016

SESION VIJUES I FORUMIT NË KONÇE



Komuna e Konçës, më 22 shtator, mbajti sesionin e gjashtë të forumit në kuadër të procesit të forumit buxhetor për krijimin e buxhetit për vitin 2016.

Forumi, në prani të 40 banorëve të komunës, i prezantoi rezultatet nga realizimi i buxhetit për vitin 2016. Në kuadër të buxhetit, banorët e kësaj komune përcaktuan si prioritete 26 projekte prej të cilave sivjet janë realizuar 17 projekte.

Në kuadër të projekteve të realizuara, komuna i prezantoi ndërtimin e kanalizimit fekale, ndërtimin e rrugës në Konçe,

rikonstruksionin e shtëpive kulturore në fshatin Dedino dhe në fshatin Rakitec, ndërtimin e rrugëve në fshatrat Lipoviq i Poshtëm dhe Dedino, etj.

Po ashtu, banorët gjatë procesit të forumit, dhanë rekomandime të caktuara që komuna u obligua t'i realizojë në periudhën e ardhshme.

KOMUNA E KRIVOGASHTANIT PREZANTOI ATË QË ËSHTË REALIZUAR PËR VITIN 2016

Komuna e Krivogashtanit, në sesionin vijues të forumit që u mbajt më 23 shtator, i prezantoi rezultatet nga buxheti i realizuar për vitin 2016, që vjeshtën e kaluar banorët e kësaj komune e "përpiluan" bashkë me komunën.



Forumi, në prani të rreth 50 pjesëmarrësve, bëri të ditur se gjatë këtij viti janë realizuar ose janë në realizim e sipër 21 prej gjithsej 30 projekteve që i përcaktuan si prioritete banorët e Krivogashtanit dhe që u bënë pjesë e buxhetit për vitin 2016.



Një pjesë e projekteve të realizuara kanë të bëjnë me sallën e re sportive të shkollës, ndërtimin e rrugës rajonale nga Krivogashtani deri në Vogjani, ndërtimi i rrugës nga Obërshani deri në Borotinë, ndërtimi i rrugës në Krivogashtan, Bella Çërkva dhe Vogjani, etj.

KOMUNA E DEMIR KAPISË I PREZANTOI REZULTATET NGA VITI 2016

Sesioni vijues i forumit nga procesi buxhetor në Komunën

e Demir Kapisë u mbajt më 27 shtator, në prani të 60 banorëve të komunës, në hapësirat e fondacionit "Cenet".

Forumi i prezantoi rezultatet nga procesi i forumit buxhetor në komunë, në kuadër të të cilave banorët, bashkë me autoritetet komunale, e përgatitnin buxhetin për vitin 2016.



Sipas raportit të administratës lokale, prej gjithsej 24 projekteve që ishin përcaktuar si prioritet në forum në kuadër të buxhetit komunal, gjashtë projekte janë realizuar tërësisht, shtatë janë në realizim e sipër, ndërsa 11 projekte do të realizohen vitin e ardhshëm. Forumi prezantoi edhe realizimin e katër rekomandimeve prej gjithsej 14 që kanë rezultuar nga banorët e kësaj komune. Një pjesë e rekomandimeve nuk janë në kompetencë të komunës për çka do të informohen institucionet kompetente.



KOMUNA E ROSOMANIT E PREZANTOI BUXHETIN E REALIZUAR PËR VITIN 2016

Rreth 70 banorë të Komunës së Rosomanit morën pjesë në sesionin vijues të forumit nga procesi buxhetor, që u mbajt më 28 shtator në hapësirat e SHF "Pere Toshev".

Forumi i prezantoi rezultatet nga procesi i forumit buxhetor në këtë komunë, në kuadër të të cilit banorët, bashkë me autoritetet komunale, e përpilonin buxhetin për vitin 2016. Gjithashtu, forumi i prezantoi rezultatet nga realizimi i buxhetit për vitin 2016, gjegjësisht projektet që banorët i zgjedhën si parësore gjatë këtij viti.



Prej 24 projekteve që ishin përcaktuar si prioritet në sesionin e pestë të forumit, 9 projekte kanë përfunduar tashmë, 13 janë në rrjedhë e sipër dhe në faza të ndryshme të zbatimit – dokumentacioni i përpiluar teknik, thirrje e përgatitur dhe publikuar për furnizim publik, etj, ndërsa dy projekte do të realizohen vitin e ardhshëm.



FORUMI NË PROBISHTIP PËR PROJEKTET E REALIZUARA NË VITIN 2016

Komuna e Probishtipit e mbajti sesionin vijues të forumit nga forumi buxhetor i 29 shtatorit, në prani të 100 banorëve të komunës.

Forumi i prezantoi projektet e realizuara që qytetarët i përcaktuan si prioritet për vitin 2016, si dhe realizimin e përgjithshëm të buxhetit për vitin 2016, sipas programeve buxhetore.



Prej gjithsej 20 projekteve që ishin përcaktuar si prioritet nga banorët për sivjet, dhe u miratuan nga buxheti komunal, katër

projekte kanë përfunduar, 10 projekte janë në realizim e sipër, nëntë projekte ende nuk kanë filluar të realizohen, ndërsa dy projekte zhvillohen në vazhdimësi.

Realizimi i përgjithshëm i buxhetit për vitin 2016 arrin mbi 50 për qind me tendencë që të rritet deri në fund të këtij viti.



SESIONI VIJUES I FORUMIT NË MAKEDONSKI BROD

Komuna e Makedonski Brodit, më 29 shtator, e mbajti sesionin vijues të forumit në kuadër të procesit të forumit buxhetor, në prani të 50 banorëve.

Forumi e prezantoi buxhetin e realizuar dhe projektet e parashikuara për vitin 2016, duke përfshirë edhe prioritetet e banorëve të komunës.

Prej gjithsej 31 projekteve, sa i prezantuan pjesëmarrësit e forumit për sivjet, 6 projekte janë realizuar, 22 projekte janë në rrjedhë e sipër, ndërsa tre



projekte janë lënë për realizim vitin e ardhshëm. Në mesin e projekteve që janë realizuar ose realizimi i të cilave është në rrjedhë, janë ndërtimi i rrugës lokale për fshatin Mogilec, terren sportiv për destinime të ndryshme në fshatin Samokov, rregullim i shpellës Peshna, ndërtim i tregut, ndërtim i terrenit për tenis në Makedonski Brod, etj.

FORUMI NË DELLÇEVË PËR PROJEKTET E REALIZUARA NË VITIN 2016

Komuna e Dellçevës e mbajti sesionin vijues të forumit nga forumi buxhetor o 30 shtatorit, në prani të 88 banorëve të komunës.



Forumi i prezantoi projektet e realizuara që qytetarët i përcaktuan si prioritetet për vitin 2016, si dhe realizimin e përgjithshëm të buxhetit për vitin 2016, sipas programeve buxhetore. Prej gjithsej 33 projekteve që u përcaktuan si prioritetet nga banorët për sivjet, si dhe u miratuan në buxhetin komunal, deri në muajin shtator janë realizuar 11 projekte, në fazë të realizimit janë 12 projekte, ndërsa nuk janë realizuar 10 projekte.

Në kuadër të projekteve parësore, janë ndërtuar dhe shtruar me pllaka rrugë në disa vendbanime, filloi të realizohet strategjia lokale për turizëm, u përpiluan disa plane urbanistike, etj.



SESIONE TË FORUMIT PËR BUXHETIN NË VITIN 2017

GRADSKO PËR HERË TË PARË FILLOI TË ZBATOJË FORUM BUXHETOR

Komuna e Gradskos e mbajti sesionin e parë të forumit më 30 shtator, në prani të 52 banorëve të komunës, në hapësirat e bodrumit të verës "Stobi".

Forumi buxhetor, i cili për herë të parë mbahet në këtë komunë në kuadër të programit "Forume në bashkësi", e prezantoi strukturën e buxhetit për vitin 2017, si dhe prioritetet e ardhshme të komunës.

Banorët, diskutimet dhe propozimet e të cilëve zhvillohen në përputhje me interesat e tyre, e strukturuan forumin me gjashtë tavolina të punës – Arsimit dhe Kulturë, Sport dhe Rekreacion, Veprimtari komunale, Urbanizëm, Mbrojtje sociale dhe administratë komunale.

Forumi formoi edhe grup punues me nga dy anëtarë nga secila tavolinë e punës, që do të marrë pjesë në takimet e punës ndërmjet sesioneve dhe do ta monitorojë procesin buxhetor dhe strukturimin buxhetor të propozimeve të qytetarëve.

GRUPET OPERATIVE TRAJNOHESHIN PËR ZBATIMIN E FORUMIT BUXHETOR



Rreth 100 përfaqësues prej dhjetë komunave në Maqedoni morën pjesë në trajnimin për ekipet komunale për zbatimin e forumeve buxhetore, që u mbajt në shtator, në hotelin "Porta" në Shkup, në kuadër të programit "Forume në bashkësi".

Përfaqësues të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Gradsko, Mogillë, Studeniçan, Koçanë, Probishtip, Pehçevë, Berovë dhe Saraj u njoftuan me procesin e forumit, procesin e buxhetimit participues, përgatitje dhe miratim të buxhetit të komunës, si dhe rolin dhe detyrat e anëtarëve të grupeve operative, moderatorët dhe bashkëmoderatorët në kuadër të procesit buxhetor.

Trajnimi kishte për qëllim që t'i trajnojë pjesëmarrësit për atë se si dhe pse mbahen proceset e forumit

buxhetor, përmes trajnimeve dhe diskutimeve për përgatitjet dhe zbatimin e sesioneve të forumit, si dhe shkëmbim të përvojave nga modelimi i forumeve buxhetore.

Trajnimi u mbajt në kuadër të ciklit të tretë nga "Faza dalëse" e programit "Forume në bashkësi" që deri tani përfshiu 28 komuna

që zbatuan 30 procese të Forumit buxhetor.

Programi "Forume në bashkësi" prej vitit 2006 deri në vitin 2016 u mbajt në 59 komuna të cilat implementuan edhe nga disa herë tre lloje të forumeve – të projektit, ndërmjet komunave dhe forum buxhetor.



TRAJNIM PËR PREZANTIM EFEKTIV TË BUXHETEVE KOMUNALE

pues, buxhetim programor në komunitet dhe prezantim i qartë i buxheteve të NJVL-ve, si dhe kornizë kohore dhe mundësi për përfshirjen e qytetarëve.

Në kuadër të trajnimit u prezantuan edhe modelet e ndryshme dhe instrumenteve për konsultim me qytetarët, si dhe përcaktimi i prioriteteve të propozimeve dhe kërkesave të tyre, me fokus të veçantë në procesin e Forumit buxhetor.

Pjesëmarrës në trajnimin ishin përfaqësues nga sektorët për buxhet dhe financa në: Gjevgjeli, Koçanë, Qytetin e Shkupit, Vinicë, Kumanovë, Saraj, Gradsko, Çuçer Sandevë, Qendrën Zhupë, Probishtip, Pehçevë, Bërvenicë, Shën Nikollë, Novaci, Nagoriçan i Vjetër, Kërçovë, Mogillë dhe Zhele. Trajnimi u organizua nga Njësia për Koordinimin e Forumeve – NJKF në kuadër të Programit “Forume në bashkësi”.

Trajnim në temën “Prezantim efikas i buxheteve komunale para qytetarëve”, që ishte dedikuar për persona të punësuar në sektorin për financa dhe buxhet në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale në Maqedoni, u mbajt në qershor të këtij viti, në hotelin “Porta” në Shkup.

Ngjarja dyditëshe, ku ishin të pranishëm 20 pjesëmarrës prej 18 komunave, kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve të administratave komunale me njohuri dhe shkathtësi për prezantimin efikas të buxheteve komunale para qytetarëve.

Temat kryesore që u shqyrtuan në kuadër të trajnimit janë buxhetimi participues – koncept, karakteristika themelore dhe zbatim i buxhetimit partici-



Përgatitja e materialit: Njësia për koordinimin e forumeve në bashkëpunim me grupet operative nga të gjitha komunitetet
Dizajni dhe vula: Grafisto; Tirazhi: 790

